



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:096692
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05615358

CPK.nr.15/24
P.nr.637/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm-Divisioni civil, përmes gjyqtarit G. A, në procedurën përmbare, sipas propozimit për përmbare të kreditorit, K. T nga Gj. të cilën me autorizim e përfaqëson av. F.S nga Gj., ndaj debitorit Komuna e N. – DKA, me seli në Novobërdë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 18.03.2024, të ushtruar ndaj Urdhërit Përmbare P.nr.637/24, i dt. 11.03.2024, të Përmbaresit Privat, jashtë seancës gjyqore, më datën 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i datës 18.03.2024, të debitorit, Komuna e Novobërdës – DKA, të paraqitur kundër Urdhërit Përmbare P.nr.637/24, i dt. 11.03.2024, të Përmbaresit Besnik Nuhiu nga Gjilani.

II.Mbetet në fuqi Urdhërit Përmbare P.nr.637/24, i dt. 11.03.2024, të Përmbaresit Privat.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, B. N nga Gj., me Urdhërin Përmbare P.nr.637/24, i dt. 11.03.2024, ka lejuar përmbaremin e propozuar nga kreditori K. T nga Gj., ndaj debitorit Komuna e N. – DKA, lidhur me përmbushjen e obligimeve, që ka debitori ndaj kreditorit ashtu që obligohet debitori që brenda afatit prej shtatë ditë nga data e dorëzimit të urdhërit, t'ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej 2386.20€, me kamatë prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë 14.04.2020, e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 404€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare në shumën prej 184.08€, të gjitha në bazë të dokumentit përmbare Aktgjykimit me C.nr.49-20 të datës 01.12.2020, e i cili është bërë i plotfuqishëm me dt. 26.10.2022 dhe i ekzekutueshëm me dt. 20.06.2023.

Në afatin ligjor me datë 04.01.2023, debitori Komuna e N. ka ushtruar kundërshtim duke theksuar se në bazë të aktgjykimit të formes së prerë C.nr 49/20 të datës 01.12.2020 , i cili është bërë i plotfuqishëm i datës 26.10.2022 me propozim të përfaqësuesit të kreditorit , përmbaresit privat ka dhënë urdhër për pagesën e borxhit me shumën prej 2790.20 euro me

kamat 8% nga data e paraqitjes së padis deri në pagesen perfundimtare si dhe shpenzimet e përmbarimit .

Debitori konsideron se nuk ka pasur kushte ligjore që gjykata ta caktoj përmbarimin në kuptimit të nenit 22 dhe 29 të LPP-së , andaj në fund ka propozuar që gjykata të merr aktvendim që ta aprovoj kundërshtimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdherin përmbarimor.

Kreditori brenda afatit ligjor me datën 20.03.2024, ka ushtruar përgjegje në prapësim, duke theksuar se kreditori procedurën përmbarimore e ka inicuar në bazë të aktgjykimit i cili i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 20 të LPP-së, i cili është i ekzekutueshëm dhe kjo e bënë të përshtatshëm për përmbarim, andaj kundërshtimi i debitorit është ushtruar për zvarritjen e procedurës dhe pretendimet e debitorit nuk kanë bazë .

Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimi dhe ta lë në fuqi Urdhëri Përmbarimor P.nr. 637/24, i datës 14.03.2024.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, e refuzon prapsimin e debitorit si te pa bazuar, për shkak se i njehti nuk përmbush asnjë nga kushtet e parapra të nenit 71 të LPP-së, kjo për shkak se Aktgjykimit me C.nr.49-20 të datës 01.12.2020, e i cili është bërë i plotfuqishëm me dt. 26.10.2022 dhe i ekzekutueshëm me dt. 20.06.2023, është dokument përmbarimor – titull përmbarimor, në bazë të të cilit është lejuar Urdhëri Përmbarimor, konform nenit 22 par 1 nën para 1.1, i LPP-së, në të cilën shprehimisht parashihet se “*vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese*”.

Nga të cekurat më lart e në pajtim me nenin 5, 22, 71, 72 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
CPK.nr.15/2024 datë 24.04.2024

Gjyqtari
G. A

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij vendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan .